# AKT THEMELIMI

Sot, me daten 29/3/1995, ne Kruje, une Ismet Mavriqi, biri i Aliut dhe Shobiqes, datelindje 1962, lindur ne Arameras dhe banues ne Fushe Kruje, me leternjoftimi N F Nr. 235894, vendosa te krijoje shoqerine me pergjegjesi te kufizuar " B R I A N Z A 2 " ne kushtet qe vijojne:

NENI 1:

Emertimi i shoqerise do te jete " BRIANZA 2 ".

NENI 2:

Shoqerija do te kete seline e saje ne Fushe Kruje.

NENI 3:

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete: Shitblerje artikuj industrial, ushqimor, material ndertimi, prodhime bujqesore, pesticide e plehra kimike, pjese kembimi per automjete, karburante e paisje te mjeteve matese. Prodhim e shitje blloqe cimento, parafabrikate, gure, gelqere, rere. Ndertime te ndryshme. Klub e restorant. Hotel. Servis automjetesh. Transport mallrash. Import eksport.

NENI 4:

Kohezgjatesija e veprimtarise se shoqerise do te jete 15 vjet.

NENI 5:

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 100,000 leke te depozituara ne banken Kombetare Tregtare Kruje me mandat arketimin Nr...... date..../3/1995, i gjith prone e imja.

NENI 6:

E gjith veprimtarija e shoqerise udhahiqet nga legjislacioni i shtetit Shqiptar. Personalitetin e vet juridik, aje, e fiton qe nga momenti i rregjistrimit ne rregjistrin tregtar prane gjykates se rrethit Tirane.

NENI 7:

Drejtimi i shoqerise realizohet nga une Ismet Mavriqi, krijues, ortak i vetem dhe administrator i shoqerise.

NENI 8:

Fitimi neto i shoqerise i perket teresisht ortakut te vetem.

Sipas dispozitave ligjore ne fuqi, fitimi, lirisht, mund te eksportohet jasht shtetit.

NENI 9:

Kompetencate e ortakut te vetem administrator si dhe te administratoreve joortak, te drejtat dhe detyrat e shoqerise, rregullat e administrimit dhe te pasqyrimit te rezultateve, menyrat e ndryshimit te shoqerise si dhe mbarimit e likujdimit te saje caktohen ne statutin e shoqerise.

...........

**NENI 10:**

Çdo ndryshim ne aktin e themelimit dhe ne statutin e shoqerise behet me vendim te ortakut te vetem.

**NENI 11:**

Ky akt i themelimit ka si pjese perberese statutin e shoqerise.

**NENI 12:**

Ky akt i themelimit i cili u redaktua ne kate kopje nenshkruhet prane zyrave te noterise me daten 26/7/1995.

OKTAKU I VETEM ADMINISTRATOR
( Ismet Mavriqi )

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTERIJA E DREJTESISE
N O T E R I A

NR. 2813
NR. 1153

V E R T E T I M

Sot, me daten 26/7/1995, ne TIRANE para meje noteres Shkendie Shahu u paraqit shtetasi shqiptar Ismet Mavriqi identiteti i te cilit shenohet ne fillimin e ketij akti, me zotesi te plote per te vepruar i cili, me vullnet te lire, ne prani t'ime firmosi kete akt te themelimit te SHPK "BRIANZA" . Dhe une, pergjegjes, ne baze te ligjit e vertetoj.

PULLE TAKSE
5 LEKE
SHQIPERISE

N O T E R E
( NOTERE
SHKENDIE SHAHU )

# S T A T U T

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "BRIANZA 2"

Ne Kruje,me daten 29/3/1995;une Ismet Mavriqi,biri i Aliut dhe i Shahides,datelindje 1963,lindur ne Arameras dhe banues ne Fushe Kruje, shtetas shqiptar,me leternjoftimi NF Nr.293934,miratova statutin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "BRIANZA 2" si vijon:

## KREU I PARE

## EMERTIMI,SELIA,KOHEGJATESIJA,KAPITALI,OBJEKTI

NENI 1:

Shoqerija emertohet " BRIANZA 2 "SHPK.

NENI 2:

SHPK "BRIANZA 2"eshte person juridik shqiptar.Ajo e fiton personalitetin juridik qe nga momenti i rregjistrimit ne rregjistrin tregtar prane gjykates se rrethit Tirane.

Krijimi dhe veprimtarija e shoqerise bazohet ne ligjin 7638 date19/11/1992 " Per shoqerite tregtare "

NENI 3:

Selia e shoqerise eshte ne Fushe Kruje.

NENI 4:

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete 15 vjet.Ky afat mund te zgjatet nese vendos ortaku i vetem.

NENI 5:

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:Shitblerje artikuj industrial,ushqimor,material ndertimi,prodhime bujqesore,pesticide e plehera kimike,pjese kembimi per automjete,karburante e paisje te mjeteve matese.Prodhim e shitje blloqe cimento,parafabrikata,gure,gelqere,rere.Ndertime te ndryshme.Klub restorant.Hotel.Servis automjete sh. Transport mallrash.Import eksport.

NENI 6:

Kapitali themeltar i shoqerise eshte ne nje shume prej 100.000 leke te depozituara ne banken kombetare tregtare Kruje.Ky mund te krijohet edhe ne formen e kontributit ne natyre.

Kapitali themeltar nuk mund te perfaqesohet nga letra me vlere t tregtueshme as me kontribut ne sherbime.

Kapitali themeltar ndahet ne 100 pjese te barabarta.Vlera nominale e cdo pjese eshte 1000 leke.Keto jane te transferueshme por te pa tregtueshme

Kapitali themeltar mund te zmadhohet kur vendos ortaku i vetem. Ne kete rast shuma e caktuar per zmadhim duhet te depozitohet ne banke brenda 8 diteve nga data e marrjes se vendimit.

NENI 7:

Zvogelimi i kapitalit themeltar nen shumen 100.000 leke e detyron shoqerine te shnderrohet ne nje forem tjeter perveç kur,ortaku i vetem, vendos rritjen e tij deri ne shumen e siperme.

NENI 8:

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve ( kur ka ),ne rruge trashegimije,ne rast ndarje pasurore midis bashkeshortve si dhe ndermjet te paralindurve dhe te paslindurve. Ky veprim duhet bere me akt noterial.

Kapitali themeltar mund te lihet peng ose t'u kalohet personave tjere qe nuk bejne pjese ne shoqeri kur vendos ortaku i vetem.

KREU I DYTE

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 9:

Ortaku i vetem eshte organi me i larte i shoqerise.

NENI 10:

Jane ne kompetence te ortakut te vetem sidomos:

a/ Ndryshimi i aktit te themelimit dhe statutit te shoqerise.

b/ Miratimi i buxhetit vjetor,i raportit te administrimit,te inventareve,te bilancit dhe te llogarive vjetore.

c/ Zgjedhja e administratorit joortak dhe caktimi i kompetencave te tij.

ç/ Aprovimi i garancive qe jep shoqerija.

d/ Caktimi i nivelit te pagave.

e/ Pranimi i njerzve ne pune.

f/ Caktimi i formes se vules.

g/ Emeron,kur eshte rasti,likujdatorin e shoqerise.

gj/ Te kryej gjitha veprimet e administrimi ne interes te shoqerise

NENI 11:

Administratori joortak i shoqerise ka sidomos keto te drejta e detyra:

a/ Te mireadministroj pasurine e shoqerise.

b/ Te beje marrveshje me te tretet brenda objektit te veprimtarise se shoqerise dhe kompetencave te caktuara.

c/ Te pergjigjet per demet qe i siell shoqerise veprimet e tij qe vijne ne kundershtim me ligjet dhe kete statut.

ç/ Te paguht per punen qe kryen ne baze te marrveshjes se bere.

d/ Te marre te dhena dhe te paraqes proposime qe i çmon te dobish per veprimtarine e shoqerise.

KREU I TRETE

TE DREJTAT DHE DETYRAT E SHOQERISE

Neni 12:

............

Shoqerija ka te drejte:

a/ Te eksportoj dhe te importoj mallra sipas objektit te vep.saje.

b/ Te caktoj çmimin e produktevе qe trajton dhe te sherbimeve qe kryen.

c/ Te siguroj pasurine e vet pa kufizim.

ç/ Gezon te drejten e favoreve e perjashtimeve nga tatimet e tjere qe njihen me ligj.

d/ Te investoj nga fitimet e veta kudo ne shqiperi.

e/ Te punesoj punonjes te thjesht dhe specialist,vendas e te huaj.

NENI 13:

Shoqerija ka per detyre:

a/ Te depozitoj ne kohe kapitalin themeltar.

b/ Te jap garanci per mallrat qe trajton dhe sherbimet qe kryen.

c/ Te siguroj punonjesit qe ka punesuar.

ç/ Te plotesoj detyrimet fiskale dhe sociale dhe detyrimet tjera ndaj shtetit si dhe detyrimet kontraktuale ndaj personave tjere.

KREU I KATERT

MAREDHENJET EKONOMIKO FINANCIARE

NENI 14:

Veprimtarija e shoqerise zhvillohet ne perputhje me leverdishmerine e saje dhe pasqyrohet ne bilanc.

NENI 15:

Xhirollogarite e veta shqoerija i mban ne banken e shtetit Kruje. Llogarite mbahen ne leke dhe pasqyrohen ne librat perkatese.

NENI 16:

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

NENI 17:

Se seline e shoqerise mbahet dokumentacioni i rregullt financiar ne baze te te cilit brenda 31 marsit te çdo viti nxiret bilanci.Bilancit i bashkangjiten dy situasione,njeri per garancite dhe tjetri per sigurimet qe ka bere shoqerija.

NENI 19:

Shoqerija mund te marr kredi ne leke dhe ne valute nga bankat vendase dhe te huaja,sipas rregullave te caktuara.

NENI 20:

Nga fitimet e realizuara gjat vitit,shoqerija,pasi ben zbritjen humbjeve te vitit te mepareshem ( kur ka )lene menjeane 5% te fitimit me te cilin krijohet fondi " Rezerve e domosdoshme "gjer sa ky fond te arr ne masen 10 % te kapitalit themeltar.

NENI 21:

Nga fitimet e vitit financiar,plus fitmet e vitit te kaluar ( k

...............

ka ),minus humbjet,fondin rezerve dhe pagen e administratorit joortak ( k kur ka )diferenca i perket ortakut te vetem.

KREU I PESTE

MBI DISA DISPOZITA TE VEÇANTA TE SHOQERISE

NENI 22:

Shoqerija ka vulen e vet e cila permban emertimin e saj dhe element te tjere te nevojshem.

NENI 23:

Shoqerija me punonjesit qe do te punesoj,para marrjes ne pune mund t' marre ne prove.Pas marrjes ne pune me secilin punonjes lidhet kontrate individuale pune.Kur eshte rasti lidhet edhe kontrate kolektive.Kontratat lidhen konforem dispozitave ligjore qe rregullojne maredhenjet e punes.

Per te punesuarit mbahet nje rregjister i posaçem dhe per secilin te punesuar njoftohet organi shteteror perkates.

NENI 24:

Ne seline e shoqerise mbahet nje rregjister i veçante ne te cilin shenohen te gjitha vendimet qe merr administratori.

NENI 25:

Shoqerija,ne maredhenjet me te tretet perfaqesohet nga z. Ismet Mavriqi.Ky,ne raste te veçanta kur e ç̶ çmon te dobishme per shoqerine mund te autorizoj edhe persona tjeter per ta perfaqesuar ate.

NENI 26:

Gjitha mosmarrveshjet qe mund t'i lindin shoqerise me persona vendas ose te huaj zgjidhen nga gjykatat shqiptare perveç kur ne marveshje te veçanta eshte parashikuar ndryshe.

KREU I GJASHTE

SHNDERRIMI,SHPERBERJA,PRISHJA DHE LIKUJDIMI

I SHOQERISE

NENI 27:

Shnderrimi i SHPK ne shoqeri kolektive ose komandite mund te behet me vendim te ortakut te vetem.

Shperberja e shoqerise mund te behet me ane bashkimi ose ndarje, veprime qe sjellin prishjen e shoqerise qe zhduket pa likujdim dhe kalimin e plote te trashegimise saje shoqerise perfituese.Per ortaket,nje veprim i tille siell marrjen e cilesise se ortakut ne shoqerine perfituese sipas kushtove qe caktohen ne aktin e themelimit.

NENI 28:

Shoqerija prishet kur plotesohet afati i veprimtarise se saje ose kur vendos ortaku i vetem.Ne kete rast,administratori cakton likujdatorin. Shoqerija mund te prishet edhe me vendim te organit kompetent shteteror veprimet e saje vijne ndesh me ligjen .Ne kete rast likuidatorin e

e cakton gjykata.

NENI 29:

Kohegjatesija e veprimtarise se likujdatorit nuk mun te jete tej vjeteve.Gjat kesaj periudhe ai e perfaqeson shoqerine,administron pasurin e saje,paguan kreditoret dhe pjesa qe i mbetet ia kethen ortakut te vetem

NENI 30:

Likujdatori pergjigjet per demet qe i sjell shoqerise ose persona tjere nga veprimet e tij te fajeshme e te kundraligjeshme.

NENI 31:

Ky statut i cili u redaktua ne kater kopje hyn ne fuqi qe nga momenti qe firmoset prane zyrave noteriale.

NENI 32:

U nenshkrua ne TIRANE me daten 26/7/1995.

ORTAKU I VETEM ADMINISTRATOR
( Ismet Mavriqi )

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIJA E DREJTESISE
N O T E R I A

NR. 2813...
NR. 1153...

V E R T E T I M

Sot,me daten 26/7/1995,ne TIRANE para meje noteres Shkendie Shahu u paraqit shtetasi shqiptar Ismet Mavriqi identiteti i te cilit shenohet ne fillimin e ketij statuti,me zotesi te plote per te vepruar,i cili,ne prani t'ime me vullnet te lire firmosi statutin e sipershenuar.Dhe une,persasiper ne baze te ligjitw e vertetoj.

PULLE TAKSE

N O T E R E
NOTERE
SHKENDIE SHAHU